



KONTRATA SOCIALE POGRADEC

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

SHTATOR2021 - SHTATOR2022

Viti i III-të i monitorimit

PËRGATITUR NGA:

RINIA PËR INTEGRIM, AKTIVIZIM DHE SENSIBILIZIM



POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
Shtator 2021 – Shtator 2022

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve, projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë;
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës;
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan;

Ky raport është përgatitur nga organizata “Rinia Për Integrim Aktivizim dhe Sensibilizim” në kuadër të projektit POP “Monitorimi i zbatimit të Kontratës Sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy”. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve, organizatës “Rinia Për Integrim Aktivizim dhe Sensibilizim”.

Tabela Përmbledhëse

Falenderime	5
HYRJE.....	6
Procesi i formulimit të prioriteteve të Kontratës Sociale	8
1. Gjetje nga viti i parë i monitorimit, periudha Gusht 2019- Gusht 2020	9
2. Gjetje nga viti dyte i monitorimit, periudha Shtator 2020 - Shtator 2021.....	10
3. Analiza e gjetjeve për secilin prioritet për periudhën Shtator 2021- Shtator 2022	13
Rekomandime	25

Falenderime

Për të hartuar këtë raport bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Pogradec, dhe drejtoritë përkatëse për përgjigjet e shpejta brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Pogradec, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë kësaj periudhe një vjeçare. Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit “Përballja e Ofertave Politike” (POP), të cilët, si ne, po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit si dhe Bordin Rinor Këshillimor Pogradec, si një partner besnik në të gjithë rrugëtimin tonë

*Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.*

HYRJE

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2021-2022 për të tretin vit me rradhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Ky është viti i tretë i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale.

Kontrata Sociale në Pogradec¹ përmban 10 prioritete që qytetarët e Tiranës identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Organizata RIAS, synoi të krijojë dhe të promovojë mekanizma qytetare në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. RIAS mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Pogradec, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin e Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre, por duke përdorur edhe zgjedhjet parlamentare të 2021, advokoi me të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale.

Në vitin e parë të monitorimit të kontratës sociale për bashkinë Pogradec, rreth 60 % e prioriteteve të qytetarëve u adresuan. Gjatë vitit të dytë të monitorimit për përmbushjen e kontratës sociale, bashkia e Pogradecit arriti të adresonte 80% të prioriteteve të kësaj kontrate duke i hapur rrugë kështu rivlerësimit nga ana e Bashkisë edhe të prioriteteve të tjera të dala nga takimet periodike mes komunitetit dhe RIAS.

Raporti² i vitit të parë monitorues dhe raporti³ i vitit të dytë monitorues janë ndarë gjerësisht me përfaqësues të bashkisë Pogradec si edhe me qytetarët duke analizuar arritjet por edhe

¹ Kontrata Sociale me bashkinë Pogradec: <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-pogradec/>

² Raporti I vitit të parë monitorues: https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti_POP_Bashkia_Pogradec.pdf

³ Raporti I vitit të dytë monitorues https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/01/Raporti_POP_Bashkia_Pogradec.pdf

punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioriteteve që janë adresuar pak dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor. Janë dy çështje kryesore që organizata dhe rrjeti po llojnë së bashku me qytetarët: **Prioritet 7:** Zhvillimi i programeve në lidhje me nxitjen e biznesit nga të rinjtë dhe/ose gratë. Parashikimi në buxhet për krijimin e një fondi “start-up” për të rinjtë dhe **Prioritet 8:** Krijimi i Programeve të Bashkisë - Intership me pagesë - për nxitjen e punësimit në përgjithësi dhe programe të veçanta me prioritet të rinjtë dhe gratë.

Të dyja këto prioritete janë të një rëndësie të veçantë dhe fokusi kryesor në vijim të monitorimit për zbatimin e Kontratës Sociale.

Për të mbërritur në vitin e tretë të monitorimit, gjatë vitit 2022, projekti vazhdoi me “Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca”, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022.

Gjatë vitit të tretë të monitorimit Organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.
- Të përdorë gjetjet e Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”⁴ për angazhimin dhe informimin e qytetarëve
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

Metodologjia

Për të realizuar raportin RIAS, pjesë e rrjetit POP u bazua në hapat si më poshtë:

- Monitorim i punës së Bashkisë Pogradec dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022;
- Shkëmbim informacioni nëpërmjet kërkesës për informim me Bashkinë Pogradec, bazuar në prioritetet e Kontratës Sociale;

⁴ Raporti Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” Korrik 2022
<https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-pogradec/>

- Analizë dhe monitorim i vendimeve të Këshillit Bashkiak Pogradec që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale;
- Realizimi i takimeve me përfaqësues të Keshillit Bashkia Pogradec dhe Bashkisë.
- Realizimi i fokus grupeve dhe takimeve me qytetarët në lidhje me përmbushjen e prioriteteve të përcaktuara në Kontratën Sociale;
- Analizë dhe monitorim i mediave sociale të Bashkisë Pogradec dhe Këshillit Bashkiak;
- Analizimi i monitorimit të mediave audiovizive dhe on line, në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

Procesi i formulimit të prioriteteve të kontratës sociale

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE

Për identifikimin e prioriteteve të komunitetit për Bashkinë Pogradec, u realizuan 6 forume me banorë të Bashkisë Pogradec përgjatë muajit Mars 2019, me qëllim identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej gjashtë forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, si dhe studentë, shtëpiake apo persona të grupeve të marginalizuara.

Në secilin prej forumeve të zhvilluara, qytetarët diskutuan gjerësisht mbi çështje të ndryshme që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejt mbi komunitetin vendor:



Për secilën prej çështjeve objekt diskutimi, ata dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi prioritetet që sipas tyre duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve, prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe:

- ✓ Ndërhyrje prioritare, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
- ✓ Ndërhyrje disi prioritare, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;

U formuluan dhe listuan sipas shkallës së rëndësisë nga vetë komuniteti, 47 prioritete.

LOBIMI DHE MONITORIMI I VAZHDUESHEM

Gjatë vitit 2020 është vijuar me “Monitorimin e zbatimit të Kontratës Sociale në nivel lokal.” POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratën Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec. Gjithashtu, synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Organizata “Rinia Për Integrim Aktivizim dhe Sensibilizim”, në bashkëpunim me komunitetin dhe Bordin Rinor Keshillimor, ka monitoruar pushtetin lokal në lidhje me prioritetet e formuluar në Kontratën Sociale 2019 për Bashkinë Pogradec.

Me datë 23.06.2019 u firmos Kontrata Sociale me 10 prioritetet më të rëndësishme mes kandidatit për Kryetar Bashkie Z. Ilir Xhakolli dhe organizatës RIAS.

1. Gjetje nga viti i parë i monitorimit, Gusht 2019- Gusht 2020

- Bashkia Pogradec, sipas njoftimeve në faqen zyrtare Facebook, lajmëron se ka ngritur ekipin e koordinatorëve të lagjeve dhe fshatrave në njësitë përkatëse. Ata do të jenë personat e parë të trajtimit të ankesave apo problematikave nga më të voglat deri tek më të ndërlikuarat.
- Bashkia Pogradec ka nisur investimet për përmirësimet e rrugëve të ndryshme në zonat administrative dhe në fshatra. Sipas një publikimi nga Bashkia “Në Dardhas-Osnat-Niçë po punohet për rehabilitimin e këtij aksi, deri në financimin e plotë të projektit që kemi për këtë rrugë. Nuk do të mungojë mirëmbajtja e saj me mjetet e Bashkisë për të bërë të mundur lëvizjen e banorëve.”
- Këshilli Bashkiak, që nga konstituimi i tij, ka vazhduar punën normalisht duke u mbledhur të paktën një herë në muaj ose më shumë në varësi të nevojave. Për periudhën mars 2020 – maj 2020, që është edhe periudha e kufizimeve të lëvizjes për shkak të pandemisë botërore Covid 19, Këshilli Bashkiak i ka realizuar mbledhjet në distancë nëpërmjet programeve të internetit, pra nëpërmjet takimeve online. Diskutimet e Këshillit janë publikuar në rrjetin social facebook të Këshillit Bashkiak.⁵

⁵ https://www.facebook.com/watch/live/?extid=0&v=292815715046268&ref=watch_permalink
<https://www.facebook.com/110757260459936/posts/140254024176926/?extid=0&d=n>

- Sipas Rregullores Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Bashkiak Pogradec: “Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit për këshilltarët dhe qytetarët bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Kur në rend të ditës janë çështje, të tilla si: buxheti apo paketa fiskale, njoftimi për këshilltarët duhet të bëhet jo më pak se 10 ditë para datës së mbledhjes.” Kjo dispozitë është zbatuar gjithmonë dhe për transparencë me qytetarët njoftimet për mbledhjen e Këshillit Bashkiak janë afishuar në Këndin Informativ, i cili ndodhet përpara Bashkisë së Pogradecit.
- Përsa i përket njoftimit online, Këshilli Bashkiak Pogradec ka hapur faqen e tij në Facebook në 15 janar 2020, dhe, si fillim, janë publikuar vetëm vendimet e Këshillit Bashkiak prej muajit maj, dhe në vazhdim janë publikuar edhe njoftimet për mbledhje së bashku me rendin e ditës.
- Këshilli Bashkiak ka miratuar disa akte sociale që kanë të bëjnë me Programin e Subveconimit të interesave të kredisë bankare, ndihmë financiare për familjet që kanë pësuar dëmtime nga rënia e zjarrit, nga termeti, rrëshqitja e tokës:
 - Krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të situatës së krijuar nga COVID 19.
 - Dhënie bursë për maturantët ekselentë.
 - Privatizim i banesave shtetërore që kanë mbetur pa u privatizuar.
 - Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2023.
 - Mbështetje ekonomike për familjet që kanë pësuar dëmtin nga zjarret apo rrëshqitja e tokës.
 - Në lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale, rezultojnë se janë bërë hapa pozitive nga ana e Bashkisë Pogradec në disa fusha si:
 - Punësimi i dy të rinjve në sektorin e Rinisë dhe Kulturës brenda Bashkisë Pogradec;
 - Hapja e një qendre rinore,
 - Shtimi i fondit të librit në Bibliotekën e qytetit,
 - Në tetor të vitit 2019, Bashkia Pogradec ka nisur procesin e buxhetimit me pjesëmarrje duke realizuar disa takime me komunitetin dhe grupet e interesit. Takimet për projekt-buxhetin e 2020 u realizuan me Komunitetin Rom dhe Egjiptian, grupe të artistave, biznese, banorë të qytetit, etj.
- Minoriteti rom dhe egjiptian kanë qënë përfitues të banesave sociale që u ndërtuan ose u rikonstruktuan nga Bashkia në të gjithë teritorin e saj.

2. Gjetje nga viti i dytë i monitorimit, periudha Shtator 2020 - Shtator 2021


Gjetjet nga informacioni i mbledhur për periudhën shtator 2020 – shtator 2021, në lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale:

- 1.1** Bashkia Pogradec në lidhje me prioritetet 1 dhe 2 ka pasur zhvillime pozitive. Në organigramën e Bashkisë Pogradec, specifikisht në Drejtorinë e Turizmit, Trashëgimisë

Kulturore, Sportit dhe Rinisë funksionojnë tre sektorë me specialistët dhe përgjegjësit përkatës. Sektori i Rinisë ka të punësuar 1 përgjegjës dhe dy specialistë.

- 1.2** Bashkia Pogradec ka rialokuar një fondi specifik për Sektorin e Rinisë dhe, ndërkohë, përgjatë vitit, ka mbështetur inisiativa të ndryshme nga të rinjtë në fushën e artit, sportit dhe kulturës. Me vendimin 144 datë 24.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Miratimi dhe detajimi i buxhetit të Bashkisë Pogradec 2021”, u arrit dhe detajimi i zërit të buxhetit për të rinjtë me vlerën 500,000 lekë për vitin 2021.
- 1.3** Bashkia Pogradec, për prioritetin 4, Rikonstruksioni i Bibliotekës së qytetit dhe shtimit të fondit të librit, konfirmon që ka një rritje prej 1% të fondit të librit për Bibliotekën dhe rikonstruksioni i saj i domosdoshëm ka përfunduar.
- 1.4** Në lidhje me prioritet nr.10 mbi procesin e konsultimit me qytetarët për projektbuxhetin e vitit 2022 si dhe projektbuxhetin afatmesëm 2022 – 2024 , Bashkia Pogradec ka mbajtur disa takime të cilat janë publikuar dhe në media sociale. Në kuadër të planifikimit Bashkia Pogradec ka bërë takime me përfaqësues nga qyteti dhe njësitë e tjera administrative, si dhe me target grupe të ndryshme si gratë, bizneset, operatorë turistikë, komunitetin Rom dhe me të rinjtë.
- 1.5** Në lidhje me prioritetin 8 dhe 9, Bashkia Pogradec po implementon një projekt për mbështetje financiare të Shtëpizës së Grave Artizane në mbështetje të grave.
- 1.6** Prioriteti nr.9 mbi “Rritja e informimit dhe adresimi i përmirësimit të komunikimit mes qytetarëve dhe punonjësve të Bashkisë, në zyrat e infomacionit dhe jo vetëm. Respektimi i mekanizmave për transparencën e publikimeve.”, qytetarët mund të aksesojnë lehtësisht informacionin e kërkuar në faqen web të Bashkisë Pogradec apo rrjetet sociale të tyre.
- a) Këshilli Bashkiak, gjatë kësaj periudhe, ka vijuar punën normalisht duke u mbledhur të paktën një herë në muaj.
 - b) Disa nga mbledhjet janë zhvilluar online për shkak të pandemisë. Pasqyrimi i tyre ka qënë nëpërmjet:
 - 1) publikimit në rrjetin social Facebook të Bashkisë Pogradec.
 - 2) transmetimit të drejtëpërdrejtë nga salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në mediat lokale.

Zhvillimi i prioriteteve sipas Raportit të monitoritmi Gusht 2019- Gusht 2020 dhe Raportit të Monitorimit Shtator 2020-Shtator 2022 të shprehura në përqindje shfaqet në grafiken 1:



Grafika 1

3. Analiza e gjetjeve për secilin prioritet sipas Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2021- Shtator 2022:

Nga komunikimet zyrtare dhe monitorimi i dokumentave zyrtare rezulton:

Prioriteti 1: *Krijimin e një sektori dedikuar të rinjve, ndryshim në organigramën e Bashkisë Pogradec, ku brenda Drejtorisë së Kulturës, Sportit, Turizmit dhe Rinisë të krijohet një sektor dedikuar të rinjve.*


Sic shikohet dhe nga raportimi i viteve të kaluara ky prioritet është realizuar 100%. Në vitin 2020, Bashkia Pogradec konfirmoi që ka ngritur një sektor pranë Drejtorisë së Kulturës, Sportit, Turizmit dhe Rinisë, ku dhe janë punësuar dy të rinj. Sipas monitorimit dhe përgjigjeve nga Bashkia Pogradec, edhe përgjatë vitit 2021 Sektori i Rinisë ka vazhduar punën dhe është zgjeruar me një punonjës të ri, duke e çuar numrin e të punësuarve në këtë sektor në tre (2 specialist dhe 1 përgjegjës). Edhe përgjatë vitit të fundit ky sektor vazhdon punën normalisht.

Prioriteti 2: *Detajimi i zërit të buxhetit për të rinjtë për të mbështetur realizimin e projekteve të planifikuara.*

Një nga arritjet më të rëndësishme ka qene vendosja e zërit të Rinisë si një zëri në vetë në buxhetin e Bashkisë Pogradec i quajtur „**Fondi i Rinisë**“ Me vendimin 144 datë 24.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Miratimi dhe detajimi i buxhetit të Bashkisë Pogradec 2021” u arrit dhe detajimi i zërit të buxhetit për të rinjtë me një vlerë prej 500,000 lekë. Përgjatë vitit, Bashkia Pogradec ka mbështetur të rinjtë në projekte të ndryshme në fushën e artit, trashëgimisë kulturore dhe kulturës.

Në takimet me të rinjtë për buxhetin e vitit 2022, është diskutuar mbi këtë fond dhe nëse do të ketë ndryshime. Bashkia Pogradec ka konfirmuar që fondet do të jetë i njëjtë dhe për vitin 2022 dhe që, gjithashtu, është parashikuar një fond prej 400,000 lekë për mbështetjen e studentëve, si për shembull: shpërblim për maturantët më të mirë si dhe një fond prej 800.000 lek për “YOUTH FEST”.

Sipas monitorimit të buxhetit dhe takimeve me të rinjtë konfirmohet që ky buxhet është përdorur për bazë materiale dhe mbështetje të aktiviteteve të ndryshme për të rinjtë në qytetin e Pogradecit. Në vazhdim RIAS do të llojë për rritjen e këtij fondi.



Pamje nga Projekti „Canoe Racing“ i realizuar në bashkëpunim me Kongresin Rinor dhe Bashkinë Pogradec, konsiston në ‘Fuqizimin e të rinjve për një mjedis të pastër nëpërmjet turizmit të aventurës dhe sporteve ujore‘.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 5767/Prot.
8

Pogradec, më 28 . 12 .2021

VENDIM

NR. 120 , DATË 24 . 12 .2021

PËR

“ MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2022”

Në mbështetje të, shkronjës "c", pika 1.3, të nenit 9, neneve 34, 40, 41, shkronjës "dh" të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor te Republikës te Shqipërisë", i ndryshuar, Aktit Normativ nr 34 date 03.12.2021 " Per nje ndryshim ne ligjin nr 137/2020, Per buxhetin e vitit 2021, te ndryshuar, Ligjin nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin"; V.K.M nr.1108, date 30.12.2015 "Per transferimin nga Ministria e Bujqesise, zhvillimin rural dhe administrimit te ujrave te Bashkites, te infrastruktures te ujitjes dhe kullimit", V.K.M nr.915, date 11.11.2015 "Per transferimin ne pronesi, nga Keshillat e Qarqeve te Bashkites, te rrjetit te rrugeve rurale dhe te aseteve te luajtshme dhe te palujtshme te ndermarjeve te mirembajtjes se ketyre rruheve"; V.K.M nr.433, date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve, kullotave publike sipas inventarit, dhe aktualisht ne administrim te Ministrise te Mjedisit e te ish komunave/bashkive", Udhezimit te Ministrise se Financave nr.2, date 06.02.2012, "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar; Këshilli Bashkiak:

Pamje nga Vendimi 120 date 24/12/2020 per miratimin e buxhetit 2022 ku shikohet dhe zeri Fondi i Rinise.

	47,271,210	000,040	3,000,000
6 Shpenzime te tjera			
Shperblim këshilltarët e kryepaq	11,462,305	10,969,617	11,000,000
Fonde për detyrime te prapambetura		20,388,540	15,000,000
Shpenzime per vendimet gjyqesore	7,250,189	20,948,217	25,000,000
Shp , komisjone vjeljen te ardh. Ujesjellesi	8,502,341	6,807,992	6,000,000
Fondi I emergjencave	4,952,854	6,249,454	18,500,000
Fond social per familjet dhe grate ne nevoje			500,000
Fond per Rinine			500,000
Fond social perkomunitet rom dhe egiptian			500,000



Prioritet 3: Ngritja dhe krijimi i Qendrës Rinore

Ka zhvillim

Qendra Rinore, që u ngrit në maj 2020, me mbështetjen e një projekti nga USAID, vazhdon punën dhe aktivitetet. Bashkia Pogradec shprehet e kënaqur me ambjentet dhe kushtet e saj. Të rinjtë nuk ndajnë të njëjtin mendim pasi, edhe pse janë të kënaqur me ekzistencën e një ambjenti të tillë, do të dëshironin një qendër rinore me standarde dhe kushte më të mira.

Sidoqoftë, përgjatë vitit 2021-2022, Qendra Rinore ka organizuar disa takime dhe aktivitete por mbetet e porealizuar 100% si prioritet pasi nuk të rinjtë kanë kërkuar një qender me të madhe.

Prioritet 4: Rikonstruksioni i Bibliotekës së qytetit dhe shtimit të fondit të librit.

Ka zhvillim

Përgjatë monitorimit të përmbushjes së prioriteteve të Kontratës Sociale, është parë dhe përmbushja prioritetit për rikonstruksionin e Bibliotekës dhe shtimit të fondit të librit. Për pjesën e parë të këtij prioriteti, atë të rikonstruksionit të Bibliotekës, vërehet që nuk ka pasur zhvillime të reja, ndërkohë që për shtimin e librit, Bashkia Pogradec njofton që fondi i librit është shtuar 2130 libra. Gjithashtu me rëndësi është dhe Biblioteka Rinore e krijuar pranë Qendres Rinore me një kapacitet prej 300 librash.

Prioritet 5: Adresimi për rikonstruksionin e shkollave në qytetin e Pogradecit dhe ndërtimi i palestrave dhe pajisja me bazë materiale në shkollat ekzistuese.

Ka zhvillim

Bashkia Pogradec deklaron që ka mbaruar rikonstruksioni i shkollave në qytet. Nga vëzhgimet në terren vërehet se:

- Shkollat “Muharrem Çollaku” dhe “Kozma Basho” kanë përfunduar rikonstruksioni dhe ndërtimi i palestrës.
- Shkolla “Gjergj Pekmezi” ka akoma probleme me ambjentet e palestrës
- Ka nisur rikonstruksioni i shkolles “14 engjejt” ne Buçimas

Bashkia Pogradec ka alokuar një fond për përmirësimin e ambjenteve të shkollës “Muharrem Çollaku” me vlerë 9,000,000 lekë me TVSH.

Prioritet 6: Shtimi i këndeve të lojrave me standarte për fëmijët.

Ka zhvillim.

Pavarësisht se Bashkia Pogradec ka parashikuar një fond prej 2,000,000 lekë për kënde lojrash për fëmijë, në vendimin 144 datë 24.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Miratimi dhe detajimi i buxhetit të Bashkisë Pogradec 2021”, në praktikë nuk shihet shumë zhvillim.

Qytetarët shprehen se këndet e lojrave janë në mungesë dhe në disa njësi administrative, si ajo e Hudënishtit, nuk ka asnjë kënd të tillë dhe nuk ka pasur asnjëherë.

Vitin e fundit sidoqoftë shikohet një ndryshim për këtë prioritet duke qene se janë ngritur disa kënde nëper lagje të qytetit të Pogradecit dhe një kënd i ri pranë bregut të liqenit.⁶



Foto nga punimet per Këndin e ri te Lojrave postuar ne faqen zyrtare te Bashkise Pogradec

Prioritet 7: Zhvillimi i programeve në lidhje me nxitjen e biznesit nga të rinjtë dhe/ose gratë. Parashikimi në buxhet për krijimin e një fondi “start-up” për të rinjtë.

Ka pak zhvillim

Në lidhje me prioritetin 7, Bashkia Pogradec ka komunikuar që ka zëruar taksën e Bashkise per bizneset qe hapen nga te rinjte e moshes 18-29 vjec per nje periudhe 12 mujore. Kjo nisem eshte bëre në kuader te nxitjes se biznesit nga të rinjte.

⁶ Postim ne faqen zyrtare te Bashkise Pogradec per promovimin e Kendit te ri per femijet prane bregut te liqenit <https://www.facebook.com/bashkiapogradec/videos/729759648105022>

Prioritet 8: Krijimi i Programeve të Bashkisë - Intership me pagesë - për nxitjen e punësimit në përgjithësi dhe programe të veçanta me prioritet të rinjtë dhe gratë.

Pak zhvillim

Nga monitorimi i kryer nga Organizata RIAS dhe nga takimet me të rinjtë, vërtetohet që ky prioritet nuk ka zhvillim. Bashkia Pogradec shpreh bashkëpunimin dhe dëshirën për të mbështetur të rinjtë, por në praktikë nuk ka asnjë iniciativë. Për këtë, RIAS mbajti një petition online drejtuar Bashkisë Pogradec dhe Këshillit mbi përmbushjen e këtij prioriteti dhe prioritetit 7.

Petitioni u firmos nga 431 persona dhe u dorëzua në Bashkinë Pogradec bashkë me një kërkesë.

Nuk kemi pasur një reagim zyrtar nga bashkia për këtë petition por shikojmë nga monitorimi që ka pasur lëvizje për të promovuar praktika të rinjve si rasti i Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

Prioritet 9: Rritja e informimit dhe adresimi i përmirësimit të komunikimit mes qytetarëve dhe punonjësve të Bashkisë, në zyrat e informacionit dhe jo vetëm. Respektimi i mekanizmave për transparencën e publikimeve.

Përsa i përket përmirësimit të komunikimit mes qytetarëve dhe punonjësve të Bashkisë Pogradec, janë vendosur në funksion zyrat e ADISA-së, të cilat lehtësojnë komunikimin me standardizim të procedurave, dixhitalizim të shërbimit dhe ngritjen e sistemeve të informacionit, ku qytetarët mund të drejtohen lirisht për të parashtruar kërkesat e tyre. Në lidhje me transparencën e publikimeve aktivitetet dhe nismat e Bashkisë Pogradec dhe institucioneve në varësi janë evidente në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec dhe faqeve zyrtare në rrjetet sociale. Gjithashtu, vendimet e Këshillit Bashkiak publikohen të gjitha në faqen <https://www.vendime.al/category/pogradec-vendime-te-keshillit-bashkiak/pogradec/>

Pavarësisht se nëpërmjet monitorimit është parë çdo vit një përmirësim i këtij prioriteti ne shohim se ka akoma vend për përmirësim kryesisht për qytetarët nga njesitë administrative dhe zonat rurale të tjera të Pogradecit.

Prioritet 10: Buxhetim me pjesëmarrje, proces transparent dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësit të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.

Bashkia Pogradec ka mbajtur disa takime të cilat janë publikuar dhe në media sociale. Në kuadër të planifikimit, Bashkia Pogradec ka bërë takime me përfaqësues nga qyteti dhe njesitë e tjera administrative, si dhe me target grupe të ndryshme si gratë, bizneset, operatorët turistikë, komunitetin Rom dhe me të rinjtë.



Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare)

November 5, 2021 · 🌐

Në Velçan dhe Udënisht vijojmë takimet me kryetarë fshatrash dhe banorë për hartimin e buxhetit dhe paketës fiskale 2022. Jemi duke mbledhur të gjitha kërkesat dhe prioritetet e banorëve për t'i reflektuar më emergjentet prej tyre në buxhetin e vitit të ardhshëm.

[#buxhetmeqytetarët](#)





Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare)

November 4, 2021 · 🌐

🇷🇸 Vijuam konsultimin e buxhetit dhe paketës fiskale 2022 me banorë dhe kryetarët e fshatrave të njësisë Proptisht në mënyrë që të arrijmë të hartojmë buxhetin e duhur për çdo njësi. Mendimet, kërkesat dhe shqetësimet e tyre na çojnë drejt një buxheti i cili vendos në qendër prioritetet e duhura.
[#buxhetmeqytetarët](#)





Në Velçan, Udënisht, Proptisht, Trebinjë, Buçimas, Dardhas janë mbajtur takime me kryetarë fshatrash dhe banorë për hartimin e buxhetit dhe paketës fiskale 2022. Jemi duke mbledhur të gjitha kërkesat dhe prioritetet e banorëve për t'i reflektuar më emergjentet prej tyre në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Këshilli i Bashkisë Pogradec në bashkëpunim me projektin Bashki të Forta ka realizuar një Sondazh Online për mbledhjen dhe identifikimin e prioriteteve të qytetarëve në lidhje me Planin Buxhetor Afatmesem 2023-2025.⁷

Kjo praktike ka nisur përgjate kohës së pandemise dhe po zhvillohet rregullisht si një mekanizem i ri për mbledhjen e informacionit dhe mendimit të qytetarëve. Sondazhe të tilla publikohen here pas here në rrjetet sociale të bashkisë Pogradec.



**KËSHILLI I
BASHKISË "POGRADEC"**



**SONDAZH PËR PËRCAKTIMIN E
PRIORITETEVE TË KOMUNITETIT**

⁷ <https://bashkiapogradec.gov.al/sondazhe-nga-keshilli.../>

Nga takimet me qytetarët dhe intervistat e strukturuar rezultojn se:

- Të rinjtë nuk ndjehen të mbështetur për punësimin dhe arsimimin dhe kërkojnë më shumë vëmendje.
- Fuqizimi ekonomik për të rinjtë dhe grate është nevojë imediate dhe duhet të gjehen mekanizma mbështetëse.
- Duhet të zgjerohet ose të ngrihet një qendër rinore e re me standarde më të mira dhe hapësira më të mëdha.
- Fondi i Rinisë duhet rritur duke rritur kështu aktivitetet dhe angazhimin e të rinjve në jetën e kulturës e Pogradecit.
- Duhet të shtohet numri i zyrave të informacionit sidomos për njësitë administrative dhe zonat rurale.
- Duhet të shihen me prioritet mbështetja e të rinjve me programe intershipi dhe fondi për start-up-e që të mos kemi shifra të larta imigrimi.
-



Foto nga takimet me komunitetin

Gjatë këtij viti të monitorimit, për periudhën shtator 2021 – shtator 2022, janë vënë re hapa pozitive në realizimin e prioriteteve nga ana e Bashkisë Pogradec.

Prioriteti	Arritja Shtator 2020- Shtator 2021	Arritja Shtator 2021- Shtator 2022
Prioriteti 1: Krijimi i një sektori dedikuar të rinjve, ndryshimi në organigramën e Bashkisë Pogradec ku brenda Drejtorisë së Kulturës, Sportit, Turizmit dhe Rinisë të krijohet një sektor dedikuar të rinjve.	100%	100%
Prioriteti 2: Detajimi i zërit të buxhetit për të rinjtë për të mbështetur realizimin e projekteve të planifikuara.	100%	100%
Prioritet 3: Ngritja dhe krijimi i Qendrës Rinore.	60%	60%
Prioritet 4: Rikonstruksioni i Bibliotekës së qytetit dhe shtimit të fondit të librit.	80%	90%
Prioritet 5: Adresimi për rikonstruksionin e shkollave në qytetin e Pogradecit dhe ndërtimi i palestrave dhe pajisja me bazë materiale në shkollat ekzistuese.	80%	90%
Prioritet 6: Shtimi i këndeve të lojrave me standarde për fëmijët.	0%	30%
Prioritet 7: Zhvillimi i programeve në lidhje me nxitjen e biznesit nga të rinjtë dhe/ose gratë. Parashikimi në buxhet për krijimin e një fondi “start-up” për të rinjtë.	30%	40%
Prioritet 8: Krijimi i Programeve të Bashkisë - Intership me pagesë -për nxitjen e punësimit në përgjithësi dhe programe të veçanta me prioritet të rinjtë dhe gratë.	0%	10%
Prioritet 9: Rritja e informimit dhe adresimi i përmirësimit të komunikimit mes qytetarëve dhe punonjësve të Bashkisë, në zyrat e infomacionit dhe jo vetëm. Respektimi i mekanizmave për transparencën e publikimeve.	70%	80%
Prioritet 10: Buxhetimi me pjesëmarrje, proces transparent dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësit të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.	80%	85%

Rekomandime

1. Të rritet fokusi i investimeve dhe ndjekjes me prioritet të problematikave në zonat rurale dhe njësitë administrative të tjera jashtë qytetit.
2. Të ngrihen mekanizma mbështetëse për punësimin e të rinjve dhe fuqizimin ekonomik duke përfshirë dhe grupet e tjera vulnerable.
3. Të bëhen takime periodike me të rinjtë për të dëgjuar prespektiven e tyre dhe për të gjetur mënyra të përbashkëta për mbështetjen e këtij target grupi dhe nevojave të tyre.

Referenca

1. Faqja web Bashkia Pogradec <https://bashkiapogradec.gov.al/>
2. Rrjeti Social Facebook Këshilli Bashkiak Pogradec
<https://www.facebook.com/K%C3%ABshilli-Bashkiak-Pogradec-110757260459936>
3. Rrjeti social Facebook Bashkia Pogradec
<https://www.facebook.com/bashkiapogradec/>
4. Kontrata Sociale me prioritetet kryesore Pogradec <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-pogradec/>
5. Faqja e postimeve të VKB <https://www.vendime.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-pogradec/>
6. Peticioni i ngritur nga RIAS <https://www.change.org/p/bashkia-pogradec-mb%C3%ABshtetje-p%C3%ABr-pun%C3%ABsimin-dhe-ngritjen-e-kapaciteteve-t%C3%AB-t%C3%AB-rinjve-dhe-grave-n%C3%AB-pogradec>
7. Raporti Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” Korrik 2022 <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-pogradec/>
8. Raporti i vitit të parë të monitorimit : https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti_POP_Bashkia_Pogradec.pdf